

**PËR FEMIJET
TANË**
më pranë • më mirë • më shumë

Arsimi *Parashkollor*

Modele dhe Praktika nga Bashkitë Shqiptare

Ky botim mbledh dhe prezanton njëmbëdhjetë praktika të mira të zhvilluara nga bashkitë shqiptare në fushën e arsimit parashkollor, në kuadër të projektit 'Bashki të Forta'. Secila praktikë është model i replikueshëm për çdo bashki që synon cilësi, barazi dhe qeverisje moderne të kopshteve publike.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige

Rreth Programit

Projekti 'Bashki të Forta' është një nismë e financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Qeveria Suedeze, e zbatuar nga Helvetas.

Qëllimi kryesor i projektit: Qytetarët shqiptarë përfitojnë nga përmirësimi i qeverisjes dhe shërbimeve në nivel bashkie, sipas standardeve minimale dhe të përballeshme të dakordësuara për një sistem të qëndrueshëm në nivel kombëtar.

Fokusi në arsimin parashkollor

Arsimi parashkollor është prioritet kombëtar dhe vendor. Fëmijët 3–6 vjeç që ndjekin kopshte cilësore kanë rezultate dukshëm më të mira gjatë gjithë jetës shkollore dhe profesionale. Megjithatë, në shumë bashki, ky shërbim vuante nga: mungesa e standardeve të unifikuara, cilësi e pabarabartë mes kopshteve urbane dhe rurale, kapacitete të ulëta menaxheriale dhe mungesë transparence dhe llogaridhënieje.


Çfarë përfaqëson ky botim?

Ky libër mbledh njëmbëdhjetë praktika të mira të zbatuara nga bashkitë partnere – Vlorë, Kukës, Korçë, Berat, Shkodër, Përmet dhe Durrës. Secila praktikë është dokumentuar me metodologjinë e zbatimit, rezultatet e matshme dhe udhëzimet për zbatim në bashki të tjera. Të marra së bashku, ato formojnë një udhëzues praktik për çdo bashki që dëshiron të modernizojë shërbimin parashkollor.

Digjitalizimi në Arsimin Parashkollor – regjistri i shërbimit

Cilat janë rezultatet?

- Të dhënat e 100% të kopshteve u integruan në një regjistrë elektronik
- 40% kohë më e shpejtë në auditim
- 25% rënie e raportimeve për mungesa pajisjesh
- Planifikim më i saktë i mirëmbajtjeve dhe investimeve
- Rritje e transparencës dhe besimit të publikut



Kush përfitoi?

- Fëmijët dhe mjediset e kopshteve: asetet dhe shërbimet menaxhohen më mirë
- Stafet drejtuese: më pak ngarkesë dhe më shumë qartësi
- Administrata bashkiake: të dhëna të sakta për vendimmarrje
- Gratë në sistem (shumica e stafit): aftësi të reja digjitale dhe rol më i fortë administrativ

Pse kjo praktikë është model për t'u ndjekur?

- Kërkon buxhet të ulët
- Përdor burimet ekzistuese njerëzore
- Rrit transparencën dhe llogaridhënien
- Është e qëndrueshme dhe e përfshirë në procedurat administrative
- Lehtëson planifikimin shumëvjeçar dhe raportimin institucional

Digjitalizimi nuk është çështje teknologjie e ndërlikuar, por e standardeve të qarta, aftësimi të njerëzve dhe vullneti për të modernizuar shërbimet.




Praktikë e mirë Digjitalizimi në Arsimin Parashkollor – regjistri i shërbimit Bashkia Kukës

Pse lindi kjo praktikë?

Menaxhimi i asetëve dhe shërbimeve në kopshtet publike bëhej me regjistra manualë, me të dhëna të paunifikuara dhe shpesh të pasakta. Kjo sillte:

- Vështirësi në auditim dhe transparencë.
- Pamundësi për planifikim të saktë buxhetor.
- Raportime të pjesshme dhe të paqëndrueshme nga kopshtet.
- Mungesë kontrolli real mbi asetet publike dhe shërbimet e ofruara.



Çfarë ndryshoi?

Bashkia Kukës ngriti një regjistër digjital unik për inventarizimin e asetëve dhe shërbimeve në të gjitha institucionet parashkollore, duke përdorur mjete të thjeshta teknologjike të paketës Office dhe duke aftësuar stafin ekzistues për ta përdorur në mënyrë efektive.

Qëllimi: Transparencë, menaxhim në kohë reale dhe planifikim më i saktë.

Bashkitë të interesuara për të zbatuar praktikën
"Digjitalizimi i Aseteve në Arsimin Parashkollor"



- | | | |
|---------------|---------------|----------------|
| 1 Shkodër | 10 Krujë | 37 Mallakastër |
| 2 M. e Madhe | 20 Shijak | 38 Patos |
| 3 Vau i Dejës | 21 Kavajë | 39 Divjakë |
| 4 Pukë | 22 Rrogozhinë | 40 Vlora |
| 5 Fushë Arrëz | 23 Elbasan | 41 Sarandë |
| 6 Lezhë | 24 Peqin | 42 Himarë |
| 7 Kurbini | 25 Gramsh | 43 Delvinë |
| 8 Kukës | 26 Belsh | 44 Konispol |
| 9 Has | 27 Librazhd | 45 Gjirokastrë |
| 10 Tropojë | 28 Korçë | 46 Përmet |
| 11 Dibër | 29 Pogradec | 47 Tepelenë |
| 12 Bulqize | 30 Maliq | 48 Memaliaj |
| 13 Klos | 31 Devoll | 49 Finiq |
| 14 Mat | 32 Kolonjë | 50 Berat |
| 15 Mirditë | 33 Dropull | 51 Kuçovë |
| 16 Kamëz | 34 Fier | 52 Dimal |
| 17 Durrës | 35 Lushnje | 53 Skrapar |
| 18 Vorë | 36 Roskovec | 54 Poliçan |

1 Analiza fillestare

- Verifikim i situatës së inventarizimit nëpër kopshte
- Identifikim i boshllëqeve në regjistrat manualë
- Krahasim i të dhënave në letër me gjendjen reale në terren

2 Hartimi i formateve standarde

- Krijimi i një formati unik elektronik për regjistrimin e të dhënave, i vlefshëm për të gjitha institucionet
- Standardizim i kategorive të aseteve: godina, pajisje, materiale, shërbime, burime njerëzore.

3 Zhvillimi i Sistemit Digjital

- Krijimi i databazës/regjistrin elektronik së përbashkët për të gjitha kopshtet
- Sigurimi i aksesit për çdo drejtues institucioni

4 Trajnimi i stafit

- Trajnim për të gjithë drejtuesit e kopshteve
- Trajnim për drejtoritë bashkiake (arsim, IT, financë)
- Udhëzime për raportim, përditësime dhe përdorim praktik

5 Verifikimi dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin elektronik

- Kontroll fizik i çdo objekti në çdo kopsht
- Regjistrim dhe përditësim i të dhënave në regjistrin elektronik
- Testim i fazës pilot përpara zbatimit në të gjitha njësitë administrative

6 Funkcionalizimi në të gjitha kopshtet

- Regjistri elektronik u plotësua me të dhënat për të gjitha kopshtet
- Drejtuesit e institucioneve filluan ta përdorin në mënyrë të pavarur
- Stafi manaxherial mori rol aktiv në monitorimin, përditësimin dhe përdorimin e të dhënave për vendimmarrje.

Metodologjia e monitorimit të zbatimit të Planit të Shërbimit të Arsimit Parashkollor

Kush përfitoi?

- Fëmijët 3–6 vjeç, që marrin shërbime më cilësore
- Edukatorët, me mbështetje dhe vlerësim profesional
- Prindërit, përmes transparencës së rritur
- Bashkia, njësitë administrative, me instrumente moderne dhe të krahasueshme.
- Praktika është e ndjeshme ndaj çështjeve gjinore, duke garantuar akses dhe përfshirje të barabartë.



Pse kjo praktikë është model?

- E qëndrueshme dhe e miratuar zyrtarisht
- Kosto e ulët, angazhim dhe trajnim i burimeve ekzistuese njerëzore
- E transferueshme në çdo bashki
- Të dhënat digjitale e bëjnë monitorimin më të shpejtë, më transparent dhe të krahasueshëm

Monitorimi funksional nuk është kontroll, është proces zhvillimi. Me tregues të qartë, mjete digjitale dhe bashkëpunim me edukatorët e prindërit, çdo bashki mund të sigurojë cilësi të qëndrueshme në shërbimin parashkollor.



Praktikë e Mirë Metodologjia e monitorimit të zbatimit të Planit të shërbimit të Arsimit Parashkollor

Pse lindi kjo praktikë?

Para nismës, monitorimi në arsimin parashkollor ishte:

- i paunifikuar,
- narrativ dhe subjektiv,
- pa tregues të qartë,
- pa analiza krahasuese,
- i varur nga interpretimi individual i punonjësve.

Si rezultat, vendimmarrja dhe buxhetimi bëheshin pa evidenca të besueshme.



Qëllimi i praktikës

Të vendosë një sistem monitorimi të standardizuar, të digjitalizuar dhe të bazuar në evidenca, i cili:

- rrit cilësinë e shërbimit,
- Forcon rolin e strukturave të bashkisë,
- siguron transparencë dhe llogaridhënie,
- mundëson planifikim dhe buxhetim të informuar.

Bashkitë që kanë hartuar dhe po zbatojnë
Planin e Përmirësimit të Shërbimit të Arsimit
Parashkollor



- | | | |
|------------------|---------------|----------------|
| 1 Shkodër | 11 Durrës | 21 Fier |
| 2 Malësi e Madhe | 12 Vorë | 22 Lushnje |
| 3 Vau i Dejës | 13 Shijak | 23 Vlora |
| 4 Lezhë | 14 Rrogozhinë | 24 Delvinë |
| 5 Kukës | 15 Elbasan | 25 Gjirokastër |
| 6 Has | 16 Belsh | 26 Përmet |
| 7 Dibër | 17 Librazhd | 27 Tepelenë |
| 8 Bulqize | 18 Korçë | 28 Memaliaj |
| 9 Mirditë | 19 Pogradec | 29 Finiq |
| 10 Kamëz | 20 Maliq | 30 Berat |
| | | 31 Dimal |

Si u zbatua kjo praktikë?

1 Hartimi

- Analiza e situatës së monitorimit të shërbimit
- Hartimi i treguesve të standardizuar
- Krijimi i formularëve digjitalë dhe listave të verifikimit

Pilotimi

2

- Testim në 10 kopshte të përzgjedhura
- Trajnim i stafit të bashkisë dhe edukatorëve
- Mbledhje e reagimeve dhe vlerësimeve nga terreni

3 Unifikimi dhe zbatimi i plotë

- Analizë e rezultateve të pilotimit
- Përmirësim i instrumenteve të monitorimit
- Standardizim në të gjitha kopshtet e bashkisë



Cilat janë rezultatet?

- Kalim nga raportime narrative në raportim me tregues dhe evidenca
- Rritje e cilësisë së të dhënave për vendimmarrje
- Edukatorët marrin feedback profesional për përmirësim
- Prindër më të përfshirë përmes pyetësorëve periodikë
- Bashkia merr vendime të bazuara në të dhëna të sakta

Fuqizimi i Rolit të NjQV-ve në Monitorimin e Planeve Vjetore dhe të Cilësisë së Mësimdhënies

Kush përfitoi?

- Fëmijët, që marrin shërbime më cilësore
- Edukatorët, që marrin feedback dhe mbështetje profesionale
- Prindërit, të përfshirë në vlerësim dhe bashkëpunim
- Bashkia, që rrit llogaridhënien dhe transparencën.
- Praktika promovon barazi mes kopshteve urbane dhe rurale, dhe mbështetje të barabartë për vajzat dhe djemtë.



Pse kjo praktikë është model?

- Kosto e ulët dhe përdorim i burimeve ekzistuese
- Instrumente të standardizuara dhe të ripërdorshme
- Qasje që fokusohet te përmirësimi, jo te kontrolli
- Përforcon rolin e qeverisjes vendore dhe profesionalizimin e edukatorëve

Monitorimi i strukturuar, instrumentet e përbashkëta dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me edukatorët mund të garantojnë cilësi të njëjtë mësimdhënieje në çdo kopsht.



Praktikë e Mirë Fuqizimi i Rolit të bashkisë në monitorimin e Planeve Vjetore të kopshtit dhe në cilësinë e mësimdhënies

Bashkitë që angazhojnë burime për mbështetjen e Konceptit Mësimor

	Po	Jo
Bashkitë që angazhojnë burime për mbështetjen e Konceptit Mësimor	29	27

Bashkia Berat

Pse lindi kjo praktikë?

Përpara nismës, roli i NjQV-ve ishte kryesisht administrativ.

- ▶ Planet vjetore ishin të përgjithshme dhe pak të zbatueshme.
- ▶ Monitorimi i cilësisë së mësimdhënies ishte i paunifikuar.
- ▶ Edukatorët nuk merrnin feedback profesional.
- ▶ Kishte dallime të ndjeshme mes kopshteve urbane dhe rurale. Kjo krijonte mospërputhje në cilësi dhe mungesë përmirësimi të vazhdueshëm.

Qëllimi i praktikës

Të forcojë rolin e NjQV-ve si struktura kyçe për:

- ▶ Monitorimin e planeve vjetore,
- ▶ Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies,
- ▶ Mbështetjen profesionale të edukatorëve,
- ▶ Sigurimin e barazisë së cilësisë në të gjitha kopshtet.

Bashkitë që kanë rritur kapacitetet për monitorimin e Planeve Vjetore të kopshteve dhe cilësisë së mësimdhënies.



- | | | |
|-----------|-------------|------------|
| 1 Shijak | 7 Berat | 13 Kurbin |
| 2 Kukes | 8 Permet | 14 Vorë |
| 3 Mirditë | 9 Tepelene | 15 Gramsh |
| 4 Lezhë | 10 Vlore | 16 Dropull |
| 5 Diber | 11 Lushnje | 17 Patos |
| 6 Korçe | 12 Librazhd | 18 Përmet |

Si u zbatua kjo praktikë?

1 Përgatitja

- Analizim i proceseve ekzistuese
- Identifikim i boshllëqeve në monitorim
- Hartim i udhëzuesit standard për planet vjetore
- Vendosje e indikatorëve të unifikuar

2 Pilotimi

- Zbatim i metodologjisë në disa kopshte të përzgjedhura
- Vizita në terren nga specialistët e NjQV-së
- Mbledhje të rregullta për feedback
- Rishikim i planeve dhe aktiviteteve mësimore

3 Vlerësim dhe përmirësim

- Analizë e rezultateve të pilotimit
- Identifikim i praktikave të suksesshme
- Përmirësim i instrumenteve për zbatim në shkallë bashkiake.



Cilat janë rezultatet?

- Planet vjetore u standardizuan dhe u bënë të zbatueshme
- Rritje e cilësisë së monitorimit nga NjQV-të
- Mbi 80% e kopshteve përmirësuan planet vjetore
- 70% e edukatorëve raportuan se ndiheshin më të mbështetur profesionalisht
- Prindërit vlerësuan përmirësim të cilësisë së aktiviteteve dhe përfshirjes së fëmijëve

Fuqizimi i Shërbimit Mbështetës përmes Mësuesve Ndhmës

Kush përfitoi?

- Fëmijët me aftësi të kufizuara, që marrin kujdes dhe mbështetje të personalizuar
- Edukatorët, të cilët lehtësojnë ngarkesën dhe rrisin cilësinë
- Prindërit, që shohin përparim të dukshëm te fëmijët.
- Komuniteti, që përfiton nga shërbime më gjithëpërfshirëse.
- Nisma ka ndikim pozitiv në barazinë gjinore dhe sociale.



Pse kjo praktikë është model?

- E bazuar në standarde dhe praktika ndërkombëtare të gjithëpërfshirjes
- Kosto e ulët krahasuar me ndikimin e madh social
- E lehtë për t'u replikuar në bashki të tjera
- Rrit cilësinë, sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve

Përfshirja e mësuesve ndhmës nuk është kosto, është investim në cilësi, barazi dhe jetë të fëmijëve. Me trajnime të duhura, përcaktim të qartë të rolit dhe bashkëpunim me prindërit, çdo bashki mund të garantojë shërbim gjithëpërfshirës parashkollor për fëmijët 3–6 vjeç.

Praktikë e mirë Fuqizimi i shërbimit mbështetës përmes mësuesve ndihmës Bashkia Shkodër

Pse lindi kjo praktikë?

Në kopshtet publike të Bashkisë Shkodër, edukatoret shpesh përballëshin me grupe të mëdha (20–30 fëmijë), ku përfshiheshin edhe fëmijë me aftësi të kufizuara (AK).

Mungesa e mësuesve ndihmës sillte:

- Vështirësi në përfshirjen e fëmijëve me AK,
- Pamundësi për kujdes individual,
- Sfida në menaxhimin e klasës,
- Cilësi të ulët të shërbimit edukativ.



Qëllimi i praktikës

Të sigurojë përfshirje të plotë dhe mbështetje individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të përmirësojë cilësinë e shërbimit në kopshte përmes rolit të mësuesit ndihmës.

Bashkitë me mësues mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Pogradec	9	Përmet	1
Dibër	2	Dimal	2
Libohovë	1	Divjakë	5
Rrogozhinë	1	Librazhd	9
Gjirokastër	7	Korçë	5
Gramsh	9	Patos	1
Belsh	2	Vore	2
Fier	8	Sarandë	7
Kukës	5	Peqin	2
Krujë	5	Devoll	3
Durrës	13	Prrenjas	1
Mallakastër	1	Selenicë	2
Kamëz	15	Cërrik	6
Mirditë	3	Mat	4
Tropojë	2	Lushnjë	8
Elbasan	12	Shkodër	14
Roskovec	2	M. e Madhe	2
Has	3	Vau Dejës	4
Berat	14	Këlcyrë	2

Si u zbatua kjo praktikë?

1 Përgatitja

- Analizë e nevojave reale në çdo kopsht
- Hartimi i profilit të punës së mësuesit ndihmës
- Hartimi i dokumentave administrative dhe udhëzimeve përkatëse

2 Pilotimi

- Përzgjedhja dhe trajnimi i mësuesve ndihmës
- Vendosja e tyre në kopshte me fëmijë me aftësi të kufizuara
- Monitorim periodik nga Drejtoria e Arsimit Parashkollor

3 Vlerësimi & përmirësimi

- Mbledhja e vlerësimeve nga edukatorët dhe prindërit
- Përmirësim i qasjes dhe roleve
- Përgatitje për shkallëzim në të gjitha njësitë administrative



Cilat janë rezultatet?

- Rritje e përfshirjes së fëmijëve me AK në aktivitetet mësimore
- Klima më e qetë, e sigurt dhe gjithëpërfshirëse në klasë
- Edukatorë më të motivuar dhe të mbështetur
- Prindër më të përfshirë dhe me besim të rritur
- Mbështetje individuale e drejtpërdrejtë për 14 fëmijë me AK (raporti 1 mësuese: 2 fëmijë me 7 mësuese ndihmëse)

Fuqizimi i Strukturave Mbështetëse të Kopshtit

Çfarë ndryshoi?

- 40% rritje e pjesëmarrjes së prindërve në vendimarrje
- Mbledhje të rregullta dhe të dokumentuara
- Komunikim më i qartë mes stafit, prindërve dhe bashkisë
- Struktura që funksionojnë si mekanizma aktivë monitorimi dhe vendimmarrjeje

Kush përfitoi?

- Fëmijët, që marrin shërbime më cilësore dhe më të sigurt
- Prindërit, të përfshirë më shumë në vendimmarrje
- Staf i kopshtit, me role të qarta dhe mbështetje nga komuniteti, për shkak të raportimit më të mirë dhe përgjegjshmërisë më të lartë.
- Nisma rriti edhe përfshirjen gjinore, pasi shumica e stafit dhe prindërve aktivë janë gra.

Pse kjo praktikë është model?

- Nuk kërkon buxhet shtesë
- Bazohet te burimet ekzistuese njerëzore
- Nxit transparencë dhe qeverisje me pjesëmarrje
- Forcon lidhjen kopsht–familje–bashki
- Krijon kulturë të re të bashkëpunimit me prindërit dhe komunitetin

Praktikë e Mirë Fuqizimi i strukturave mbështetëse të kopshtit *Bashkia Përmet*

Pse lindi kjo praktikë?

Para ndërhyrjes, Bordi i Kopshtit, Këshilli i Prindërve dhe Komisioni i Shëndetit e Sigurisë Mirëmbajtjes dhe Mjedisit ekzistonin vetëm “në letër”.

- Mbledhjet ishin të rralla dhe pa rend dite.
- Dokumentimi ishte minimal.
- Pjesëmarrja e prindërve ishte e ulët.
- Bashkëpunimi mes kopshtit, prindërve dhe bashkisë ishte i dobët.



Qëllimi i praktikës

Të kthejë këto struktura në mekanizma realë pjesëmarrjeje, transparence dhe llogaridhënieje, të aftë për të ndikuar në cilësinë e shërbimeve të kopshtit.

Bashkitë që kanë funksionalizuar Bordin e Kopshtit në çdo institucion.



Pogradec	Kavajë	Shijak	Pustec
Diber	Mallakaster	Përmet	Delvinë
Libohovë	Kurbën	Poliçan	Prrrenjas
Rrogozhinë	Kamëz	Dimal	Selenicë
Gjirokastrë	Mirditë	Dropull	Cërrik
Tepelenë	Bulqizë	Divjakë	Mat
Gramsh	Tropojë	Librazhd	Finiq
Kolonjë	Kuçovë	Korçë	Lushnjë
Klos	Elbasan	Patos	Shkodër
Belsh	Roskovec	Vorë	M. e Madhe
Fier	Has	Pukë	Vau Dejës
Kukës	Berat	Sarandë	Fushe Arrëz
Krujë	Skrapar	Peqin	Këlcyrë
Durrës	Maliq	Devoll	Memaliaj

Si u zbatua kjo praktikë?

1 Analiza fillestare

- Vlerësim i funksionimit aktual të Bordit të kopshtit, Këshillit të prindërve dhe Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit
- Identifikimi i boshllëqeve dhe problematikave reale

2 Hartimi i Udhëzuesve

- Përgatitja e përshkrimeve të roleve dhe përgjegjësive
- Saktësim i mandateve dhe mënyrës së funksionimit

3 Trajnimi i anëtarëve të komisioneve

- Sesione praktike për drejtuesit e kopshteve dhe përfaqësuesit e prindërve
- Trajnim për dokumentim, mbledhje dhe vendimmarrje

4 Krijimi i formateve dhe kalendarëve të aktiviteteve

- Dokumente standarde për mbledhjet e strukturave mbështetëse
- Modele për raportime periodike
- Kalendarë pune për secilën strukturë

5 Monitorimi dhe raportimi

- Vlerësim i pjesëmarrjes dhe ndikimit
- Përshtatje e metodave sipas nevojave të institucioneve



Planifikimi dhe administrimi i shërbimit Psiko-Social

Cilat janë rezultatet?

- Identifikim më i hershëm i vështirësive zhvillimore
- Ulje e sjelljeve problematike në grup
- Edukatorë më të sigurt profesionalisht
- Prindër më të informuar dhe më të mbështetur
- Përmirësim i ndjeshëm i mirëqenies emocionale të fëmijëve

Kush përfiton?

- Prindërit, që marrin orientim dhe mbështetje me shërbime më të targetuara dhe të standardizuara
- Një praktikë që promovon barazi dhe përfshirje sociale, pa dallim gjinie apo vendbanimi.

Pse kjo praktikë është model?

- Është kosto-efektive
- Lehtëson aksesin e barabartë për fëmijët
- Rrit kapacitetet e edukatorëve
- Forcon bashkëpunimin me prindër dhe shëndetësinë
- Është plotësisht e transferueshme në bashki të tjera

Shembulli i Beratit tregon se edhe me burime të kufizuara, një model i mirëorganizuar psiko-social mund të garantojë mbështetje cilësore për çdo fëmijë. Me trajnime, udhëzime të qarta dhe bashkëpunim me komunitetin, çdo bashki mund ta bëjë këtë shërbim të qëndrueshëm dhe efektiv.

Praktikë e Mirë Planifikimi dhe Administrimi i Shërbimit Psiko-Social Bashkia Berat

Pse lindi kjo praktikë?

Në kopshtet publike të Bashkisë Berat kishte mungesë të dukshme të shërbimeve psiko-sociale:

- Mungesë psikologësh / punonjësish socialë,
- Mungesë mekanizmesh për identifikimin e hershëm.
- Edukatorë të papajisur me mjete profesionale.
- Prindër pa mbështetje këshilluese.
- Pabarazi në akses mes zonave urbane dhe rurale.

Qëllimi i praktikës

Të sigurojë mbështetje të barabartë psiko-sociale për të gjithë fëmijët 3–6 vjeç, të forcojë kompetencat e edukatorëve dhe të krijojë një sistem bashkëpunimi mes kopshtit, familjes dhe shërbimeve shëndetësore.



Bashkitë që kanë funksionalizuar Bordin e
Kopshitit në çdo institucion.



Pogradec
Dibër
Rrogozhinë
Gramsh
Belsh
Fier
Kukës
Krujë
Durrës
Kavajë
Kamëz
Mirditë

Tropojë
Berat
Shijak
Dimal
Divjakë
Librazhd
Korçë
Patos
Sarandë
Peqin
Selenice
Malësi e Madhe
Fushe Arrez

Si u zbatua kjo praktikë?

1 Analiza e situatës

- Identifikimi i mungesave në staf
- Vlerësimi i kapaciteteve të kopshteve
- Evidentimi i fëmijëve me vështirësi të mundshme

2 Pilotimi i shërbimit

- Emërimi i një psikologu dedikuar për shërbimin parashkollor, sipas udhëzimit nr. 4611/2020
- Testimi i instrumenteve të vlerësimit për fëmijët
Vendosja e procedurave të para të referimit

3 Zbatimi i Plotë

- Trajnimi i edukatoreve për identifikim dhe referim
- Krijimi i "këndeve të qetësisimit" në kopshte
- Bashkëpunim me prindër dhe qendra shëndetësore

4 Monitorimi dhe raportimi

- Raportim mujor dhe analiza e rasteve
- Takime me prindërit për vlerësimin e progresit
- Përmirësime të procesit sipas nevojave



Planifikimi i dhe regjistrimi i fëmijëve në Arsimin Parashkollor

Si u zbatua kjo praktikë?

3 faza – 12 muaj:

- Përgatitje: Analizë e të dhënave, kalendar, standarde, trajnime
- Zbatim: Fushata informuese, sportele regjistrimi, koordinim bashki–ZVA–kopsht
- Monitorim: Analizë e rezultateve, përmirësime, raportim dhe planifikim për vitin tjetër.


Pse kjo praktikë konsiderohet "e mirë"?

- Rrit barazinë dhe përfshirjen sociale
- Forcon transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve lokale
- Ndërton kulturë planifikimi dhe partneriteti mes bashkisë, ZVA-së dhe komunitetit
- Funkcionon pa kërkuar buxhete shtesë
- Mund të replikohet lehtësisht në bashki të tjera

Partnerët kryesorë

- Bashkia Korçë, strukturat drejtuese dhe koordinuese
- Zyra Vendore Arsimore (ZVA) me procedurat referuese për regjistrimin Drejtuesit dhe edukatorët e kopshteve zbatim në terren
- Prindërit dhe komuniteti përmes bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes
- Ekspertë të Projektit "Bashki të Forta" me mbështetje metodologjike dhe teknike

Bashkitë që zbatojnë plan veprimi për rritjen e regjistrimit dhe ndjekjes së arsimit parashkollor dhe klasave përgatitore për gjithpërfshirjen e fëmijëve, përfshirë grupet në nevojë sociale (romë, egjiptianë, fëmijë me aftësi të kufizuara).



Praktikë e mirë Planifikimi i dhe regjistrimi i fëmijëve në Arsimin Parashkollor Bashkia Korçë

Pse kjo praktikë është e rëndësishme?

Bashkia Korçë ka ndërtuar një model të suksesshëm për regjistrimin sezonal e fëmijëve në kopshte, duke e kthyer procesin nga një fluks i paparashikuar në një sistem të qartë, transparent dhe të planifikuar.

Ky model ka reduktuar vonesat, ka rritur aksesin e të gjithë fëmijëve në arsimin parashkollor, si dhe ka vendosur standarde të reja për menaxhimin lokal të shërbimit të arsimit parashkollor.

Cilat ishin sfidat?

- Regjistrime të grumbulluara vetëm në shtator
- Mbingarkesë në kopshte urbane dhe boshatisje në zonat rurale
- Mungesë udhëzimesh të unifikuara për regjistrimin në kopshte
- Prindër të painformuar dhe raste të përjashtimit të fëmijëve vulnerabel
- Ngarkesë administrative për edukatorët dhe drejtuesit e kopshteve



Bashkitë që zbatojnë plan veprimi për rritjen e regjistrimit dhe ndjekjes së arsimit parashkollor dhe klasave përgatitore për gjithpërfshirjen e fëmijëve përfshirë grupet në nevojë sociale (romë, egjiptianë, fëmijë me aftësi të kufizuara)



Rrogozhinë
Kolonje
Belsh
Fier
Kukës
Krujë
Kamëz

Mirditë
Tropojë
Elbasan
Roskovec
Berat
Përmet
Divjakë

Librazhd
Patos
Vorë
Sarandë
Këlcyrë
Korçë
Shkodër

Çfarë solli praktika e re?

Zgjidhje e bazuar në planifikim dhe koordinim

- Kalendar i vjetor i regjistrimeve, i publikuar për komunitetin
- Procedura të standardizuara të regjistrimit sipas vendbanimit
- Fushata informuese për prindërit në komunitet dhe media
- Mekanizëm i përbashkët bashki–ZVA për shpërndarjen e drejtë të fëmijëve sipas kapacitetit të kopshteve
- Mbledhje dhe analizë të vazhdueshme të të dhënave për çdo sezon regjistrimi

Rezultatet kryesore

- 95% e regjistrimeve të kryera brenda afatit
- 40% ulje e numrit të fëmijëve të paregjistruar
- 25% më shumë fëmijë nga zonat rurale të përfshirë
- Reduktim i mbingarkesës në institucionet urbane
- Një praktikë e qëndrueshme tashmë e integruar në ciklin vjetor të planifikimit të shërbimit të bashkisë

Kush përfitoi?

- Fëmijët 3–6 vjeç, sidomos ata nga familje vulnerabël
- Prindërit (veçanërisht nënat), për shkak të procedurave më të qarta
- Edukatorët dhe drejtuesit e kopshteve që menaxhojnë më pak fluks sezonal
- Komuniteti, përmes aksesit më të drejtë dhe barazisë gjinore në përfshirje



Taksa e Përkohshme për përmirësimin e Arsimit Parashkollor

Kush përfiton?

- Fëmijët 3–6 vjeç, me ambiente të sigurta dhe shërbim cilësor
- Edukatorët, me kushte pune dhe trajnime më të mira
- Nënata, të cilat përfitojnë nga rritja e cilësisë së kujdesit
- Komuniteti i biznesit, që kontribuon në një shërbim publik të dukshëm.



Pse kjo praktikë është model?

- Model inovativ financiar që rrit autonominë vendore
- Transparencë dhe përgjegjshmëri në përdorimin e taksave
- Mund të replikohet në bashki të tjera në rast emergjencash ose mungesash financiare
- Përmirëson cilësinë e shërbimit pa rënduar qytetarët

Shembulli i bashkisë Durrës tregon se një taksë e përkohshme lokale, e përcaktuar mirë, transparente dhe e drejtpërdrejtë në qëllim, mund të krijojë fonde të qëndrueshme për përmirësimin e arsimit parashkollor, pa rritur barrën e qytetarëve dhe duke forcuar solidaritetin komunitar.

Praktikë e Mirë Taksa e Përkohshme për përmirësimin e Arsimit Parashkollor Bashkia Durrës

Pse lindi kjo praktikë?

Pas tërmetit të vitit 2019:

- Grantet qeveritare dhe të donatorëve nuk mbulonin urgjencën.
- Kërkesa për shërbime cilësore për fëmijët 3–6 vjeç ishte në rritje.

Bashkia kishte nevojë për një mekanizëm të drejtë, transparent dhe të qëndrueshëm për të rikthyer në funksion institucionet parashkollore.

Zgjidhja inovative: Taksa e përkohshme

U vendos një taksë vendore e përkohshme për një peirudhë trevjeçare, e dedikuar posaçërisht për arsimin parashkollor, e aplikuar vetëm për bizneset e mëdha, me qëllim krijimin e një fondi të qëndrueshëm për rikonstruktion, pajisje dhe përmirësim të shërbimit.



Taksa e Përkohshme për përmirësimin e Arsimit Parashkollor



Bashkia Durrës

The image features a map of Albania, where each county is represented by a grid of white dots. A single dot in the northern coastal region is highlighted in yellow, indicating the location of Durrës. A semi-transparent green box with the text 'Bashkia Durrës' is positioned over this dot. The background of the entire page is a faded, green-tinted photograph of a young child sitting on the floor, looking down at something in their hands.

Si u zbatua kjo praktikë?

1 Analiza fillestare

- Vlerësim i dëmeve në kopshte
- Përlllogaritje e nevojave reale financiare

2 Hartimi i propozimit të taksës së përkohshme

- Përcaktimi i bazës së taksimit
- Vlerësimi i bizneseve që mund të kontribuojnë
- Planifikimi i investimeve

3 Miratimi dhe komunikimi publik

- Takime konsultative me bizneset, prindërit, OJQ-të
- Informim dhe shpjegim i ndikimit dhe transparencës fiskale e financiare

4 Zbatimi


- Mbledhja e fondeve
- Investime në kopshte: rikonstrukcion, pajisje didaktike, kushte pune
- Menaxhim financiar nga Drejtoria e Financës dhe ajo e Arsimit

5 Monitorimi dhe raportimi publik i vazhdueshëm

- Raportime tremujore
- Borde këshilluese me përfaqësues të komunitetit
- Publikimi i rezultateve dhe progresit

Rezultatet kryesore

- Rikonstrukcion i kopshteve të dëmtuara
- Mjedisë më të sigurta dhe moderne për më shumë se 1,000 fëmijë
- Pajisje bashkëkohore didaktike dhe rritje e cilësisë mësimore
- Besim i rritur i komunitetit për shkak të transparencës
- Efikasitet më i madh në përdorimin e fondeve publike



Unifikimi i një Seti Didaktik për fëmijët 3–6 vjeç

Kush përfiton?

- Fëmijët 3–6 vjeç, që marrin materiale cilësore dhe të përshtatura
- Edukatorët, që punojnë me mjete standarde dhe të strukturuar, që shmang shpenzimet fragmentare
- Bashkia, që shmang shpenzimet fragmentare dhe planifikon më mirë buxhetin për pajisjet didaktike.
- Komuniteti, përmes barazisë në shërbim. Seti është neutral gjinor dhe përfshin materiale edhe për fëmijët me nevoja të veçanta.

Pse kjo praktikë është model?

- Standardizon cilësinë në të gjitha institucionet
- Kombinon udhëzimet kombëtare me fleksibilitet lokal
- Ul kostot dhe rrit efikasitetin
- Lehtëson integrimin e teknologjisë dhe materialeve digjitale
- Është e plotësisht e transferueshme në bashki të tjera



Standardizimi i materialeve nuk kufizon krijimtarinë, përkundrazi, krijon bazën për cilësi të barabartë dhe planifikim më të lehtë. Me pilotim, konsultim dhe trajnime, çdo bashki mund të unifikojë setin didaktik për fëmijët 3–6 vjeç dhe të rrisë ndjeshëm cilësinë e arsimit parashkollor.



Praktikë e Mirë Unifikimi i një Seti Didaktik për fëmijët 3–6 vjeç Bashkia Berat

Pse lindi kjo praktikë?

Para nismës, çdo kopsht përdorte materiale të ndryshme didaktike, disa të blera individualisht, disa të improvizuara, disa të dhuruara nga projekte të ndryshme.

- Mungesë koherence pedagogjike,
- Pabarazi në cilësinë e përgatitjes së fëmijëve,
- Vështirësi për edukatorët në planifikim,
- Boshllëqe në përvojën arsimore të fëmijëve që transferoheshin nga një kopsht në tjetrin.

Qëllimi i praktikës

Të krijojë një set didaktik të unifikuar, të standardizuar dhe në përputhje me kurrikulën kombëtare, për të garantuar:

- Cilësi dhe barazi,
- Lehtësim të punës së edukatorëve,
- Përputhshmëri pedagogjike në të gjitha kopshtet publike.



Bashkitë që raportojnë përbushjen e nevojave të kopshteve me materiale didaktike dhe mësimore



Pogradec
Libohovë
Rogozhinë
Gjirokastër
Kolonjë
Fier
Kukës
Kavajë
Kamëz
Mirditë
Tropojë
Has

Berat
Skrapar
Shijak
Përmet
Poliçan
Dimal
Dropull
Divjakë
Korçë
Vorë
Pukë
Sarandë

Peqin
Devoll
Pustec
Delvinë
Selenicë
Cërrik
Finiq
Shkodër
M. e Madhe
Fushë Arrëz
Memaliaj

Si u zbatua kjo praktikë?

- 1 Analiza e nevojave
 - Grumbullim i të dhënave mbi mungesat ekzistuese
 - Inventarizim i materialeve në çdo kopsht
- 2 Hartimi i setit didaktik
 - Hartimi i përmbajtjes mësimore dhe vizuale
 - Përgatitja e udhëzuesit pedagogjik
 - Përfshirja e ekspertëve të zhvillimit të hershëm
- 3 Pilotimi dhe trajnimi
 - Testimi i setit në disa kopshte për feedback praktik
 - Trajnimi i edukatorëve për përdorimin e tij
 - Adaptimi final dhe miratimi nga njësia përgjegjëse e arsimit në bashki



Rezultatet kryesore

- 25% reduktim i kohës së përgatitjes së orëve mësimore
- Rritje e sinkronizimit të përmbajtjes mes kopshteve
- Përmirësim i planifikimit pedagogjik
- Kursime financiare për bashkinë dhe edukatorët
- Përvoja të barabarta për fëmijët në të gjitha institucionet

Vlerësimi i Performancës së Drejtuesve tëkopshiteve

Rezultatet kryesore

- Rritje e motivimit të drejtuesve
- Përmirësim i menaxhimit të brendshëm
- Vlerësim i qartë dhe gjithëpërfshirës
- Rritje e besimit të prindërve dhe komunitetit
- Identifikim më i saktë i nevojave për trajnime

Kush përfiton?

- Drejtueset e kopshteve, të cilat marrin vlerësim të drejtë dhe zhvillim profesional
- Edukatorët, që punojnë me udhëheqje më të qartë
- Prindërit, të përfshirë në vlerësim
- Bashkia, me një sistem të qartë menaxhimi të burimeve njerëzore.



Standardizimi i materialeve nuk kufizon krijimtarinë, përkundrazi, krijon bazën për cilësi të barabartë dhe planifikim më të lehtë. Me pilotim, konsultim dhe trajnime, çdo bashki mund të unifikojë setin didaktik për fëmijët 3–6 vjeç dhe të rrisë ndjeshëm cilësinë e arsimit parashkollor.



Praktikë e mirë Vlerësimi i Performancës së Drejtuesve të kopshteve Bashkia Vlorë

Pse lindi kjo praktikë?

Para nismës, drejtuesit e kopshteve vlerësoheshin në mënyrë:

- Subjektive
- Jo të unifikuar
- Pa tregues të qartë
- Me raporte të pjesshme dhe të pakrahasueshme.

Kjo krijonte pabarazi në cilësinë e udhëheqjes, mungesë motivimi dhe vështirësi për bashkinë në mbështetjen e drejtueseve.

Qëllimi i praktikës

Të krijojë një metodologji transparente, të drejtë dhe të standardizuar për vlerësimin e performancës së drejtuesve të kopshteve, duke garantuar:

- Llogaridhënie,
- Cilësi në udhëheqje,
- Motivim profesional,
- Përmirësim të vazhdueshëm.



Vlerësimi i Performancës së Drejtuesve të kopshteve

Bashkia Vlorë



Si u zbatua kjo praktikë?

1 Përgatitja

- Hartimi i rregullores së vlerësimit
- Ndërtimi i formularëve të vetëvlerësimit
- Përgatitja e pyetësorëve për prindërit, edukatorët dhe përfaqësuesit e bordit të kopshtit

2 Pilotimi & zbatimi

- Trajnim i stafit bashkiak dhe drejtuesve
- Shpërndarja e pyetësorëve
- Mbledhja dhe analiza e të dhënave

3 Analiza & përmirësimi

- Dorëzimi i rezultateve për çdo drejtues
- Shqyrtim nga strukturat e burimeve njerëzore dhe Kryetari i Bashkisë
- Përditësim i instrumenteve për ciklin e ardhshëm



Çfarë përfshin vlerësimi?

- Planifikimi dhe zbatimi vjetor
- Menaxhimi i stafit dhe burimeve
- Bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin
- Cilësia e aktiviteteve mësimore
- Menaxhimi financiar
- Përmirësimi i mjedisit të institucionit